

**AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"ENI XHIXHO" sh.p.k.**

Në Tiranë, sot më datë 04/03/2023 :

Z. ENTEL XHIXHO, shtetas Shqiptar, lindur ne Lubonje, me 01/07/1991 dhe banues ne adresen Rruga "SHABAN BARDHOSHI", Nd. 11, H 1, 1027, Tiranë Shqipëri, mbajtës i Pasaportës Biometrike me nr. BF5466096 dhe nr. personal J10701086C.

Në cilësinë e "ortakut themelues" ka rene dakort per hartimin e këtij akt themelimi, nëpërmjet të cilit deklarohet se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, "**ENI XHIXHO**" sh.p.k

**NENI 1
EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Themelohet shoqëria me emrin "**ENI XHIXHO**" sh.p.k, Shoqëria do ti nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do t'i nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelues dhe Statutit të shoqërisë të miratuar nga ortaku dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar (më poshtë e quajtur "Shoqëria").

**NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK**

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB (Qendra Kombëtare e biznesit), në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqëria "**ENI XHIXHO**" SHPK, është një shoqëri tregtare me përgjegjesi të kufizuar.

**NENI 3
SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria e ka selinë në Njësia Administrative Farkë, Rezidenca "Kodra e Diellit", Ap. 23, Objekti A2/3, 1, 20m2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nepermjet vendimit vetëm nga Administratori si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

**NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË**

Shoqëria ka për objekt:

KOMPANIA SHERBEN PËR: SHËRBIME PROFESIONALE, TRAJTIME BUKURIE TË NDRYSHME NË AMBIENT EDHE NË TERREN SIPAS DËSHIRËS SË KLIENTIT/KLIENTEVE. KURSE DHE TRAJNIME PRIVATE PËTRAJNIMET E BUKURISË.

SHËRBIMET QË OFROHEN SI PRERJE, KREHJE, TRAJTIME, STILIME, LYERJE FLOKËSH ETJ.

MAKE UP PROFESIONAL, STILIME NUSESH.

**NENI 5
KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit. Shoqëria e fiton personalitetin e vet nga momenti i regjistrimit ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit (QKB).

**NENI 6
KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali i shoqërisë tregtare është 10.000 Lekë (dhjetë mijë leke te reja). Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë me vlerë, si me poshte:

Z. Entel Xhixho, zoterues e 1 (një) kuote që përfaqëson 100% të kapitalit të shoqërisë me vlerë 10.000 ALL (dhjetë mijë lekë të reja).

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kapitali fillestar i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet dhe është totalisht i likuidueshëm dhe i nënshkrueshëm.

Ortaku i vetëm i shoqërisë angazhohet me detyrën për të shtuar volumin e veprimtarisë së shoqërisë, të respektojë detyrimin e ruajtjes së sekretit të saj lidhur me tipologjinë e aktivitetit të saj tregtar dhe të mos dëmtojë interesat e shoqërisë.

NENI 7

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

b) shitblerjes;

c) trashëgimisë;

ç) dhurimit;

d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

e) orkaku ka të drejtë t'jua trashëgojë kuotat e tij bashkëshortes/bashkëshortit dhe fëmijëve.

f) në rast se ortaku dëshiron të shes një pjesë të kuotave mund ta bëjë në çdo moment dhe gjithashtu nëse në të ardhmen do të behet mer ortak pavaresisht % (përqindjes) se kuotave që do të gezoje në momentin që do të vendosi për të shitur kuotat përkatëse, duhet tu japi prioritet fillimisht ortakeve të tjere nëse do të ketë në të ardhmen nëse ata do të jene te interesuar ne blerjen e tyre, nëse asnjë nga ortakët nuk shfaq interes ai ka të drejtë të shesi kuotat e veta paleve të treta te interesuara.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

ORGANET VENDIMARRESE DHE DREJTUESE

NENI 8

ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortaku i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortak i vetëm. Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;

b) ndryshimet e statutit;

c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;

ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

l) investime;

ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

m) të bleje, shese, kembeje pasuri të patundshme të shoqërisë;

n) për shpërndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta.

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku/ortaket regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

NENI 9

ADMINISTRIMI

Administrator i shoqërisë është Z. ENTEL XHIXHO, mbajtes i pasaportes me nr. ID BF5466096 dhe nr. personal J10701086C emëruar në këtë detyrë për një afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data 04.03.2023 deri me date 03.03.2028.

Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 10

KOMPETENCAT

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) Të hapë llogari bankare dhe të operojë për llogari të kompanisë pa limit.
- f) të kërkojë financime pa limit për kompaninë nga banka apo institucione të tjera financiare;
- g) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare
- h) të blejë dhe të shesë, në emër të shoqërisë, produkte dhe çdo gje tjetër si brenda territorit të Shqipërisë ashtu dhe jashtë territorit të saj;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e asamblesë së përgjithshme edhe në rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 (pese) për qind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve të shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 11

VITI FINANCIAR DHE FITIMET E SHOQËERISË

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Me përjashtim të vitit të parë financiar që fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKB dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Fitimet e shoqërisë i takojnë ortakut të saj. Asambleja sipas ligjit vendos për ndarjen ose riqarkullimin e tyre duke përcaktuar edhe modalitetet për këtë procedurë.

NENI 12

SHPËRNDARJA OSE PRISHJA E SHOQËERISË

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblesë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;

d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Asambleja e Përgjithshme merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqeri në likuidim e sipër “.

NENI 13

EMËRIMI DHE SHKARKIMI I ADMINISTRATORËVE

Asambleja e përgjithshme emëron dhe revokon administratorin ose administratorët në fuqi dhe mund të emëroje edhe administratorë të tjerë me detyra të përcaktuara me ligj dhe në autorizim.

Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e parashikuara me ligj, për administrimin e zakonshëm të shoqërisë, të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët me përjashtim të kompetencave që vete ligji apo statuti u jep shprehimisht ortakeve.

Për çështje të rëndësishme të veçante administratori konsultohet me ortakun dhe merr masat e përcaktuara, të marra me shumicat e parashikuara me ligj.

NENI 14

TABELA, MARKA DHE SHENJA DALLUESE

Shoqëria ka vulën e saj me përmasa të zakonshme, të realizuar sipas parashikimeve të ligjit në fuqi dhe mund të ketë një marke të vetën.

NENI 15

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 16

JURIDIKSIONI

Për të gjitha konfliktet që mund të lindin midis ortakut/ëve dhe Shoqërisë dhe administratorit do të jetë kompetent juridiksioni i Republikës së Shqipërisë, me zbatimin e ligjeve shqiptare.

NENI 17

LIGJI I ZBATUESHËM

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislationin shqiptar në fuqi dhe veçanërisht të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 “për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

NENI 18

REGJISTRIMI

Ky Akt Themelimi i Shoqërisë do të hyjë në fuqi pas regjistrimit, në regjistrat përkatës, nga organet publike kompetente.

Neni 19

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 3 kopje në gjuhën shqipe, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike.

Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nën për nën nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare “**ENI XHIXHO** “ *sh.p.k* , nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tyre origjinale.

ORTAKU I SHOQERISE

"ENI XHIXHO" SHPK

ENTEL XHIXHO

STATUTI
I
SHOQËRISË
“ENI XHIXHO“ sh.p.k

Në Tiranë, sot më datë 04/03/2023 :

Z. ENTEL XHIXHO, shtetas Shqiptar, lindur ne Lubonje, me 01/07/1991 dhe banues në adresën Rruga "SHABAN BARDHOSHI", Nd. 11, H 1, 1027, Tiranë Shqipëri, mbajtes i Pasaportës Biometrike me nr. BF5466096 dhe nr. personal J10701086C.

Në cilësinë e “ortakut themelues“ ka rene dakort për hartimin e ketij akt themelimi, nëpëmjet të cilit deklaron se me vullnet të lirë, të plotë e të sigurtë, dhe iniciativën e lirë private, mbështetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperisë dhe Kodin Civil në fuqi, në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare“, ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit“, në atë Doganor, Fiskal e Tatimor, krijojnë shoqërinë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar, “**ENI XHIXHO “ sh.p.k**

NENI 1
KRIJIMI

Shoqëria “**ENI XHIXHO “ sh.p.k.** është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi te kufizuar (më poshtë e quajtur “Shoqëria”).

NENI 2
PERSONALITETI JURIDIK

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar pranë QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “**ENI XHIXHO“ sh.p.k.** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut te vetëm përben kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri në përpjestim me kuotën që ka dhënë në kapital.

NENI 3
SELIA

Shoqëria e ka selinë në Njësia Administrative Frakë, Rezidenca "Kodra e Diellit", Ap. 23, Objekti A2/3, 1, 20m2. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, edhe nëpërmjet vendimit vetëm nga Administratori si edhe të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

NENI 4
OBJEKTI I VEPRIMTARISË

KOMPANIA SHËRBEN PËR: SHËRBIME PROFESIONALE, TRAJTIME BUKURIE TË NDRYSHME NË AMBIENT EDHE NË TERREN SIPAS DËSHIRËS SË KLIENIT/KLIENTEVE. KURSE DHE TRAJNIME PRIVATE PËR TRAJNIMET E BUKURISË.

SHËRBIMET QË OFROHEN SI PRERJE, KREHJE, TRAJTIME, STILIME, LYERJE FLOKËSH ETJ..

MAKE UP PROFESIONAL, STILIME NUSESH.

NENI 5
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë fillon me regjistrimin e saj juridik dhe fiskal në (QKB) Regjistrin Tregtar, dhe do të vazhdojë për një periudhë kohore te papercaktuar.

Kreu II
Kapitali

NENI 6
KAPITALI THEMELTAR

Kapitali i shoqërisë është 10.000 Lekë (dhjetë mijë lekë të reja). Kapitali i shoqërisë është i përbërë nga 1 kuotë me vlerë, si me poshte:

Z. Entel Xhixho, zoterues e 1 (një) kuote qe perfaqeson 100% te kapitalit të shoqërisë me vlere 10.000 ALL (dhjetë mijë lekë të reja).

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë te tregëtueshme.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme ose të paluajshme apo të drejta)

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërise përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërise.

NENI 7:

ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT

Kaptiali i shoqërisë mund të zmadhohet me vendim të ortakeve duke kontribuar në natyrë ose në para dhe shërbime. Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit deri në vlerën minimale.

Kërkohet vendim i kualifikuar edhe kur zmadhimi i kapitalit ka si qëllim t'u japë mundësi ortakëve të rinj të hyjnë në shoqëri.

Me anë të një vendimit të kualifikuar, shoqëria mund ta zvogëlojë kapitalin e vet.

NENI 8:

TRANSFERIMI I KAPITALIT

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shitblerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Orkaku ka të drejtë t'jua trashgojë kuotat e tij bashkëshortës/bashkeshortit dhe fëmijeve.
- f) Në rast se ortakut i vetëm dëshiron të shes kuotat perkatese, ose të shesë një % të kuotave dhe të bëhet me ortakut ne të ardhmen nëse dëshiron të shesë kuotat e tij duhet të japi prioritet fillimisht ortakeve të tjere nëse ata janë të interesuar në blerjen e tyre, nëse asnjë nga ortakët nuk shfaq interes ai ka të drejtë të shesë kuotat e veta paleve të treta të interesuara

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, duhet të përpilohet dhe firmoset kontratë me shkrim. Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë, përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotave, deri në çastin e regjistrimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723 datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirish të transferueshme me rrugë trashëgimie.

NENI 9

ORGANI VENDIMARRËS

Asambleja e përgjithshme është organi i vetëm vendimarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm në rast se shoqëria është e themeluar nga një ortakut i vetëm. Cdo ndryshim i statutit duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Asambleja e Përgjithshme vendos për çështje si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- j) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- k) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- l) investime;
- ll) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

- m) te bleje, shese, produkte kozmetike te shoqerise;
- n) per shperndarjen e fitimit.

Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoj pavlefshmerine te tretit, qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta.

Te gjitha vendimet e marra nga ortaku regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhënat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

NENI 10 **ADMINISTRIMI**

Administrator i shoqerise eshte Z. ENTEL XHIXHO, mbajtes i pasaportes me nr. ID BF5466096 dhe nr. personal J10701086C emëruar ne kete detyre per nje afat 5 (pesë) vjeçar duke filluar nga data 04.03.2023 deri me date 03.03.2028.

Administratorët emërohen dhe shkarkohen me vendim te Asamblesë së Përgjithshme.

NENI 11 **KOMPETENCAT**

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

a) kryejë te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarisë tregtare te shoqerisë, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;

b) perfaqesojë shoqerine tregtare;

c) kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerisë;

ç) pergatisi dhe nenshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqesin keto dokumente perpara asamblesë së pergjithshme per miratim;

d) krijojë nje sistem paralajmërimi ne kohën e duhur per rrethanat, qe kercënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqerisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dergojnë te dhënat e detyrueshme te shoqerisë, siç parashikohet ne ligjin per Qendrën Kombëtare te Regjistrimit;

e) Te hape llogari bankare dhe te operoje per llogari te kompanise pa limit.

f) te kerkoje financime pa limit per kompanine nga banka apo institucione te tjera financiare;

g) raportojë perpara asamblesë së pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rëndësi te veçantë per veprimtarinë e shoqerisë tregtare

h) te bleje dhe te shese, ne emer te shoqerise, produkte te ndryshme kozmetike apo çdo lloji tjeter qe eshte objekt i kesaj shoqerie si brenda territorit te Shqiperise ashtu dhe jashte territorit te saj;

Administratori është i detyruar te thërrasi mbledhjen e asamblesë së pergjithshme edhe ne rastet kur : sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim dhe kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te blejë nga nje ortak pasuri, qe kanë vlerë më te lartë se 5 për qind te asetëve te shoqerisë, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshëm e te jashtëzakonshëm. Administratori perfaqeson Shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqësore te gjitha shkalleve. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marrëdhënie me te tretët ne emër te shoqerisë, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise.

Administratori angazhon shoqerine ne marrëdhëniet me te tretët nepërmjet akteve qe janë ne përputhje me objektin e saj.

Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te tretëve kur ajo provon se te tretët e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerisë ose kur te tretët nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 13 **VITI FINANCIAR**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Me perjashtim te vitit te parë financiar qe fillon nga data e regjistrimit te shoqerisë ne Qendrën Kombëtare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

NENI 14 **BILANCI SHOQERISË DHE DIVIDENTËT**

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, miraton bilancin

e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asamblee se Pergjithshme të shoqërisë vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jenë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

NENI 15
EKSPERTËT

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko-tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e asamblesë së përgjithshme. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorezojë në kohë asamblesë së përgjithshme për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore që ka.

NENI 16
DIVIDENTI

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbeten dhe i kalojnë në pronësi, Asamblesë së shoqërisë.

NENI 17
SHPËRNDARJA OSE PRISHJA E SHOQËRISË MUND TË BËHET NË ÇDO KOHË :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakeve të shoqërisë;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Në këtë rast Ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likujduesit e emëruar nga Ortaku i shoqërisë.

Nëse Asambleja e Përgjithshme nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

NENI 18

Likujduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likujdues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likujduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likujduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likujduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

NENI 19
TË DREJTAT E DETYRIMET E LIKUJDUESIT

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likujduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare “, likujduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likujduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likujduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likujduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

NENI 20

PËRFUNDIMI I LIKUIDIMIT

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

NENI 21

BASHKIMI

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

NENI 22

NDARJA

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..
3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes; vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

NENI 23

SHNDËRRIMI

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare. Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

NENI 24

BAZA LIGJORE

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 25

MOSMARRËVESHJET

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

NENI 26

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Ky Statut u redaktua në 3 kopje me vlera të njëjta juridike në gjuhën shqipe, dhe pasi iu lexua ortakeve themeltar të shoqërisë, nënshkruhet me vullnetin e lirë prej tyre.

ORTAKU I SHOQËRISË
"ENI XHIXHO" SHPK
ENTEL XHIXHO